



Në bazë të Ligjit për Akademinë e Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, Ligji Nr. 05/L-038, neni 14, nënparagrafi 1.2 dhe neni 23, paragrafi 1, të Statutit të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës, neni 24, paragrafi 8 dhe neni 30, nënparagrafi 1.2, Kuvendi i Akademisë, në mbledhjen e mbajtur më 18 qershor, nxjerr

RREGULLOREN PËR PROPOZIMIN DHE ZGJEDHJEN E ANËTARËVE TË AKADEMISË SË SHKENCAVE DHE TË ARTEVE TË KOSOVËS

Neni 1

1. Kjo Rregullore përcakton mënyrën e propozimit, ecurinë dhe zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës.

Neni 2

1. Kryesia me vendim të veçantë shpall zgjedhjet për anëtarë të Akademisë dhe miraton *Qarkoren për propozimin e kandidatëve për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë* (në tekstin e mëtejshëm: Qarkorja).
2. Kryesia e Akademisë shpall ditën e mbajtjes së seancës zgjedhore të Kuvendit së paku tre muaj përpara.
3. Qarkorja u dërgohet Institucioneve përkatëse.

Neni 3

1. Akademia zgjedh anëtarë të rregullt - akademikë, anëtarë korrespondentë, anëtarë të jashtëm dhe anëtarë nderi.
2. Anëtarë korrespondentë të Akademisë zgjidhen kandidatët që nuk e kanë kaluar moshën 65 (gjashtëdhjetë e pesë) vjeçare.
 - 2.1. Kandidatët të cilët në ditën e mbylljes së afatit për paraqitjen e propozimeve mbushin 65 vjet nuk mund të hyjnë në procedurën e zgjedhjeve;
 - 2.2. Afati i mbylljes së paraqitjes së propozimeve përcaktohet me Qarkore; dhe
 - 2.3. Propozimet që në Akademi arrijnë jashtë afatit të caktuar në nënparagrafin 2.1 të këtij neni, nuk do të merren parasysh.
3. Anëtarët e Akademisë zgjidhen për çdo katër vjet në seancën zgjedhore të Kuvendit të saj, me vota të fshehta.

Neni 4

1. Seksionet e Akademisë paraqesin propozimet për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë.
 - 1.1. Në rast se për ndonjë arsye objektive ndonjëri nga seksionet e Akademisë nuk është funksional, Kryesia e Akademisë, në bazë të nenit 11, paragrafi 4.1 të Statutit të Akademisë, formon një komision të përkohshëm i cili kryen të gjitha veprimet e seksionit përkatës për zgjedhjen e anëtarëve të rinj në pajtim me këtë Rregullore. Ky komision pushon së vepruari në momentin kur seksioni përkatës bëhet funksional.
 - 1.2. Komisioni i përkohshëm përbehet nga 5 anëtarë, Nënkryetari i Akademisë dhe 4 anëtarë të propozuar nga Kryesia e Akademisë.

2. Këshillat e fakulteteve të universiteteve publike dhe këshillat shkencorë të instituteve shkencore publike, që financohen nga Buxheti i Republikës së Kosovës, paraqesin propozimet për zgjedhjen e anëtarëve korrespondentë të Akademisë.
3. Kryesia e Akademisë ia paraqet Kuvendit propozimet për zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm dhe të anëtarëve të nderit.
4. Seksionet e Akademisë i caktojnë recensentët për kandidatët e propozuar për anëtarë të rregullt dhe anëtarë korrespondentë.
5. Kryesia e Akademisë i cakton recensentët për kandidatët e propozuar për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë të nderit.

Neni 5

1. Anëtarit të jashtëm të Akademisë i pranohet statusi i anëtarit korrespondent, nëse:
 - 1.1. Ka shtetësi të Republikës së Kosovës;
 - 1.2. Ka vendbanim të përhershëm në Kosovë, të dëshmuar me dokumente përkatëse;
 - 1.3. Është anëtar i jashtëm i Akademisë së paku dy mandate; dhe
 - 1.4. Ka pasur bashkëpunim të përhershëm shkencor dhe artistik me Akademinë, përmes botimeve, pjesëmarrjes në tubime shkencore dhe artistike dhe formave të tjera.
2. Procedura e ndryshimit të statusit nga anëtar i jashtëm në anëtar korrespondent mund të fillojë vetëm me kërkesë të kandidatit drejtuar Kryesisë së Akademisë.
3. Për kalimin nga statusi anëtar i jashtëm në anëtar korrespondent kandidati duhet t'i shtrohet procedurës së votimit në seksionin përkatës dhe zgjedhjes në Kuvendin e Akademisë.

Neni 6

1. Propozimet për anëtarë të Akademisë, bashkë me punime, përkatësisht dokumentacion, duhet të përmbajnë të dhënat personale të kandidatit, listën dhe vlerësimin e punimeve të tij shkencore, gjegjësisht të veprave artistike:
 - 1.1. Propozimet i paraqiten Kryesisë së Akademisë brenda afatit të paraparë në Qarkore; dhe
 - 1.2. Propozimet që i arrijnë Kryesisë jashtë afatit të përcaktuar në nënparagrafin 1.1. të këtij neni nuk merren parasysh.

Neni 7

1. Propozimet e recensentëve duhet të jenë të arsyetuara me shkrim dhe duhet të përmbajnë:
 - 1.1. Të dhënat e hollësishme për punën shkencore dhe për veprat artistike të kandidatit të propozuar;
 - 1.2. Vlerësimet e plota të propozuesve për rezultatet shkencore ose artistike të kandidatit të propozuar; dhe
 - 1.3. Të dhënat për recensionet e mëparshme për rezultatet e krijimtarisë shkencore ose artistike të kandidatit të propozuar.

Neni 8

1. Kryesia ua dërgon seksioneve përkatëse propozimet për zgjedhjen e anëtarëve korrespondentë të Akademisë që ato të shfaqin mendimet e tyre për secilin kandidat:
 - 1.1. Mendimin e tyre për kandidatët seksionet e shfaqin përmes recensioneve të më së paku dy anëtarëve të vet;

- 1.2. Nëse vlerësimi i punës shkencore ose veprave artistike të kandidatit kërkon qasje interdisiplinare, seksioni mund të vendosë që recensentët të jenë edhe nga seksionet e tjera;
- 1.3. Për zgjedhjen e anëtarëve të rregullt, recensionet i paraqesin anëtarët e rregullt;
- 1.4. Për zgjedhjen e anëtarëve korrespondentë, recensionet i paraqesin të gjithë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të Akademisë; dhe
- 1.5. Për zgjedhjen e anëtarëve të jashtëm dhe anëtarëve të nderit, recensionet i paraqesin të gjithë anëtarët e rregullt dhe korrespondentë të Akademisë.

Neni 9

1. Recensentët, brenda 15 ditësh, hartojnë recensionet të cilat ia dërgojnë seksionit përkatës bashkë me të gjitha dëshmitë:
 - 1.1. Recensionet i recensentëve duhet të përmbajë vlerësimin për punimet më të rëndësishme të kandidatit dhe vlerësimin e përgjithshëm të cilësisë dhe rëndësisë së punës shkencore ose të veprimtarisë artistike të kandidatit; dhe
 - 1.2. Në recension jepet vlerësimi nëse kandidati i plotëson kushtet që parashihen me Ligjin për Akademinë dhe Statutin e saj për t'u zgjedhur në statusin e anëtarit që propozohet.

Neni 10

1. Kryesia i njofton të gjithë anëtarët e Kuvendit dhe e informon opinionin përmes mjeteve të informimit se recensionet e recensentëve, bashkë me propozimet e arsyetuara të institucioneve jashtë Akademisë, u lihen në ambientet e Akademisë për shikim për shtatë ditë:
 - 1.1. Vërejtjet eventuale në lidhje me propozimet për zgjedhjen e anëtarëve të Akademisë i paraqiten Kryesisë së Akademisë me shkrim dhe të nënshkruara brenda kohës së paraparë në paragrafin 1. të këtij neni; dhe
 - 1.2. Pas skadimit të afatit shtatë ditor, propozimet shqyrtohen në mbledhjet e seksioneve dhe votohet për secilin kandidat.
2. Kryesia e Akademisë pas propozimit të seksionit përkatës, në bazë të përlogaritjeve buxhetore dhe në bazë të përmasave të propozimeve të arritura, për secilën seancë zgjedhore merr vendim për përcaktimin e numrit të anëtarëve të rinj, që zgjidhen, duke marrë parasysh përpjesëtimin midis seksioneve:
 - 2.1. Për marrjen e vendimeve është e nevojshme pjesëmarrja në mbledhje e më shumë se gjysmës së anëtarëve të seksionit;
 - 2.2. Seksioni në mbledhjen përkatëse mund të vendosë që në kuorum të mos përfshihen anëtarët të cilët për shkak të sëmundjes së gjatë ose për ndonjë arsye tjetër janë të penguar të marrin pjesë në punën e seksionit;

Neni 11

1. Kandidatë për anëtarë të rregullt në seancën zgjedhore të Kuvendit të Akademisë, konsiderohen kandidatët që kanë fituar shumicën e votave të anëtarëve të rregullt të seksionit.
2. Kandidatë për anëtarë korrespondentë në seancën zgjedhore të Kuvendit të Akademisë, konsiderohen kandidatët që kanë fituar shumicën e votave të anëtarëve të seksionit; dhe
3. Kandidatë për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë të nderit në seancën zgjedhore të Kuvendit të Akademisë, konsiderohen kandidatët që kanë marrë miratimin e Kryesisë.

4. Propozimet për kandidatët e votuar në seksione i dërgohen Kryesisë më së voni 10 ditë para mbajtjes së seancës zgjedhore të Kuvendit të Akademisë.
5. Në seancën zgjedhore të Kuvendit të Akademisë votohet dhe vendoset për kandidatët e votuar në seksione, Neni 11, paragrafi 1 dhe 2, e dhe për kandidatët që kanë marrë miratimin e Kryesisë, Neni 11, paragrafi 3.

Neni 12

1. Kryesia mund t'u paraqesë seksioneve vërejtjet e veta lidhur me propozimet e anëtarëve të rinj që seksionet i kanë votuar, para se t'i nxjerrë para Kuvendit propozimet e seksioneve.
2. Seksionet i shqyrtojnë vërejtjet e Kryesisë dhe marrin vendim për to.
3. Kryesia nëse nuk pajtohet me vendimet e seksioneve, para Kuvendit dalin të dy mendimet lidhur me kandidatët e propozuar të seksionit përkatës.

Neni 13

Anëtarëve të Kuvendit u dërgohen recensionet për të gjithë kandidatët më së voni shtatë ditë para mbajtjes së seancës zgjedhore.

Neni 14

1. Seanca zgjedhore e Kuvendit, në të cilën zgjidhen anëtarët e Akademisë, mbahet nëse në të marrin pjesë shumica e anëtarëve të Akademisë.
2. Anëtar i rregullt i Akademisë zgjidhet kandidati i cili merr shumicën e votave të anëtarëve të rregullt të Akademisë.
3. Anëtar korrespondent i Akademisë zgjidhet kandidati i cili merr shumicën e votave të anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë.
4. Anëtar i jashtëm dhe anëtarë i nderit i Akademisë zgjidhet kandidati i cili merr shumicën e votave të anëtarëve të rregullt dhe të anëtarëve korrespondentë të Akademisë.
5. Kuvendi në mbledhjen përkatëse mund të vendosë që në kuorum të mos përfshihen anëtarët të cilët për shkak të sëmundjes së gjatë ose për ndonjë arsye tjetër janë të penguar të marrin pjesë në punën e Akademisë.

Neni 15

1. Kuvendi në seancën zgjedhore nga radhët e veta e zgjedh komisionin e zgjedhjeve, i cili është përgjegjës për rrjedhën e zgjedhjeve dhe numërimin e votave.
2. Sekretarët e seksioneve, para shqyrtimit, paraqesin propozimet dhe arsyetimin e shkurtër (deri në 15 rreshta) për secilin kandidat.
 - 3 Shqyrtimi për kandidatët bëhet drejtpërsëdrejti para votimit sipas numrit rendor të seksioneve dhe statusit të anëtarëve të Akademisë. Votimi bëhet me fletëvotime të veçanta të vulosura, për secilin status të anëtarëve të Akademisë dhe për secilin seksion, duke rrethuar numrin rendor para emrit të kandidatit.
3. Në fletëvotim theksohet numri i vendeve të lira.
4. Nëse në ndonjë fletëvotim janë votuar më shumë kandidatë se numri i vendeve të lira, ai fletëvotim konsiderohet i pavlefshëm.
5. Renditja e kandidatëve në fletëvotime bëhet sipas rregullit:
 - 7.1. Për anëtarë të rregullt dhe anëtarë korrespondentë kandidatët renditen sipas numrit të votave të fituara në seksionin përkatës; dhe

7.2. Për anëtarë të jashtëm dhe anëtarë të nderit kandidatët renditen sipas abëcës.

Neni 16

Kuvendi zgjedh kandidatin për vendin e lirë të caktuar dhe Kandidat i zgjedhur konsiderohet kandidati i cili ka fituar shumicën e votave të anëtarëve që e përbëjnë kuorumin.

Neni 17

1. Zgjedhja e anëtarëve të rinj të Akademisë shpallet solemnisht në takim të veçantë të anëtarëve të Akademisë.
2. Anëtarëve të rinj me këtë rast u dorëzohen fletëdëshmitë përkatëse.

Neni 18

1. Fletëdëshmia e zgjedhjes përmban:
 - 1.1. Emrin e Akademisë,
 - 1.2. Emrin e mbiemrin e anëtarit të ri,
 - 1.3. Datën e zgjedhjes dhe statusin e anëtarit,
 - 1.4. Qëllimin, dhe
 - 1.5. Datën, nënshkrimin dhe vulën.

Neni 19

Me hyrjen në fuqi të kësaj Rregulloreje shfuqizohet Rregullorja nr. 446/3 e datës 11 maj 2016.

Neni 20

Rregullorja hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas miratimit të saj nga Kuvendi i Akademisë dhe pas nënshkrimit nga Kryetari i Akademisë.

Kryetari i Akademisë së Shkencave dhe të Arteve të Kosovës

Akademik Mehmet Kraja

